Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0082

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Agri Bau Sh.P.K." kundër Vendimin për anulim të aktivitetit te prokurimit të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Piruner", me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1" me 29/04/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Agri Bau Sh.P.K." me nr. 2024/82, kundër vendimit të AK-Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Piruner", me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1".

2. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i dates, 11.01.2024, për anulimin e aktivitetit prokurimit "Furnizim me Piruner", me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

3. Konfiskohet tarifa e ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndaj operatorit ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 09.08.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me Piruner", me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1". Ndërsa me datën 11.01.2024. ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 35,000.00€.

Me 15.01.2024, OE “Agri Bau Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 18.01.2024., Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Agri Bau Sh.P.K.” me nr. 82/24 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me Piruner”, me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Agri Bau Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim-

Pretendimi i parë (I): “Për shkak se AK- Policia e Kosovës: Ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.) -Ne mënyrë te kundërligjshme dy here e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës me datën 11.01.2024 ka bere publikimin e Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, ne mënyrë te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit ku shihet qarte se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me çdo kusht po tenton te na dëmtoj neve duke e anuluar kundërligjshëm këtë aktivitet te prokurimit për here te dyte, herën e pare u dashtë te ankohemi ne OSHP për ta kthyer këtë aktivitet ne Rivlerësim edhe pas vendimit te OSHP-se Zyrtari përgjegjës i Prokurimit kundërligjshëm e ka anuluar këtë aktivitet me pretekstin se kinse nuk e kemi vazhduar sigurimin e tenderit edhe pse kemi pasur validitet ne sigurim pra sigurimi jone ka qene valid. AK me date 11.01.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues B58 i cili është i bashkangjitur edhe ne ankese. Gjithashtu bashke me njoftimin e mësipërm e ka publikuar edhe letrën standarde për eliminim Arsyetim OE “AGRI BAU " SH.P.K., Prishtinë ,nuk është Rivlerësuar për shkak se me datë 25.10.2023. nga ana e AK është kërkuar që ta zgjatin validitetin e ofertave për një periudhe prej "60" ditësh nga data skadimit te validitetit të ofertës dhe sigurimit te tenderit për një periudhe prej 90 ditësh nga data e skadimit te sigurimit te tenderit, AK ka kërkuar nga OE që Dërgimi i dokumentit për Autoritetin Kontraktuese më së largu deri me 30.10.2023ora 16:00. OE është përgjigjur me datë 25.10.2023 ka vazhduar validitetin e ofertës për një periudhë 60 ditë nga data e skadimit mirëpo nuk e ka vazhduar edhe sigurimin e tenderit. Ku gjithashtu AK ne letër standarde e ka vendosur edhe përgjigjen tone. Ne ankese gjeni te bashkangjitur Përgjigje në kërkesën për vazhdim të validitetit te ofertës. Qe AK ka cekur si me poshtë se: Sipas kësaj OE në sistemin e prok. ka dhënë me shkrim për zgjatje te sigurimit të tenderit mirëpo, nuk ka ngarkuar në E prok . nga ana e OE sigurimin e tenderit . Sipas kësaj refuzohet si i papërgjegjshëm. Siç po shihet me larte nga përgjigja e dhënë pranë AK-se me date 25.10.2023 se neve ke kemi vazhduar validitetin e ofertës gjithashtu edhe kemi pranuar te vazhdojmë sigurimin e ofertës por ne kohen kur ka kërkuar AK neve kemi pasur sigurim valid ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit dhe vonesat e AK-se ne vlerësim dhe shkeljet e tyre ligjore pa kurrfarë arsye nuk do te mund te përdoren për te na ndëshkuar neve siç dihet AK i ka shkelur te gjitha procedurat ligjore si ne vonesa ashtu edhe gjate vlerësimit te ofertave neve e kemi dorëzuar sigurimin e tenderit për

Lot 1 dhe Lot 2. Neve ne përgjigjen për vazhdim te validitetit dhe sigurimit ja kemi bere me dije AK-se se pajtohemi për ti vazhduar dhe për validitet ka qene ne rregull sipas AK-se, por edhe për sigurim neve jemi pajtuar qe ta vazhdojmë dhe AK është dashur te qe ne kohen kur është afër skadimi i validitettit te na kërkoj vazhdimin e jo dy muaj me herët pasi qe këto shpenzime AK po na krijon me fajin e vet pa fajin tone pse AK me çdo kusht i zvarrit procedurat e prokurimit vetëm e vetëm për te na eliminuar dhe mos te na jep tenderin. Neve e kemi ripërtërirë sigurimin e tenderit për Lot 1 dhe Lot 2, dëshmia është e bashkangjitur ne ankese. Neve ne kohen kur jemi pajtuar për ta vazhduar validitetin e tenderit kemi pasur sigurim valid te tenderit deri me datën 01.12.2023 pra qe i bie gati katër dhjetë dite dhe AK me qellim nuk na ka kërkuar para skadimit te sigurimit te tenderit dhe e ka vonuar vlerësimin vetëm e vetëm për te na eliminuar. Neve e kemi vazhduar validitetin e tenderit dhe konform nenit 30 te Rregullores se KRPP-se me konkretisht pika 30.6 thuhet se: "Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE tëcilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK Pra neve e kemi vazhduar validitetin dhe AK nuk mundet te na eliminoj për një kërkesë te cilën e kemi plotësuar. Edhe sikur hiq te mos kishim pasur vlefshmëri te sigurimit te tenderit AK nuk ka te drejte ligjore te na eliminoj për këtë pike pasi qe neve e kemi dorëzuar sigurimin e tenderit ashtu siç është kërkuar nga AK ne dosje te tenderit por AK qëllimisht e ka zvarrit këtë procedure dhe qëllimisht na ka eliminuar kundërligjshëm si herën e pare kur na ka eliminuar për kërkesa qe nuk kane qene ne dosje te tenderit tani prape ashtu edhe herën e dyte ku nuk ka baze ligjore dhe kundërligjshëm na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit. Neve me date 15.01.2024 pranë AK-se kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku i kemi cekur te gjitha këto pretendime ankimore si me sipër ne këtë ankese dhe AK me date 18.01.2024 kundërligjshëm na refuzon kërkesën tone për rishqyrtim ku shihet qarte se AK as qe është lodhur dhe as qe ka marre mundin për ta shikuar kërkesën tone dhe cila kompani ka parashtruar kërkese për rishqyrtim dhe ne vend te emrit te kompanisë tone e vendos një emër tjetër te një kompanie tjetër si me poshtë: I. Refuzohen si të Pabazuara kërkesat për rishqyrtim nga OE "Naim Shuki B.I. , - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Fumizim me Piruner" me numër te prokurimit 214-23-8209-1-2-1; 214/23/118/121, iniciuar nga Policia e Kosovës. Gjithashtu AK thirren se kinse sigurimin e tenderit e kemi vazhduar ne kundërshtim me nenin 57 paragrafi 2 te LPP-se e qe ne fakt Ligji nuk e parasheh vazhdimin e sigurimit te tenderit pasi qe ne nenin 57.2 te LPP-se thuhet: Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit. Pra neve e kemi dorëzuar sigurimin e tenderit por me fajin e AK-se ka skaduar disa here dhe AK na ka krijuar shpenzime shtese te pa nevojshme duke e vazhduar disa here validitetin e tenderit dhe sigurimin e tenderit dhe ne kohen kur AK ka kërkuar ta vazhdojmë sigurimin e tenderit neve kemi pasur sigurim gati edhe dy muaj dhe ne deklaratën tone kemi pranuar dhe jemi pajtuar qe ta bëjmë një gjë te tille por AK është dashur qe ta vlerësoj tenderin dhe te na shpall fitues por me qellim nuk e ka bere një gjë te tille dhe e ka vonuar vlerësimin pasi qe edhe pse me qellim e ka vonuar vlerësimin bile është dashur te na njoftoj para skadimit te sigurimit para datës 01.12.2023. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit edhe pas rivlerësimit te dyte nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve .PTK dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Si dhe ne piken 2 te nenit 1 thuhet: Vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Si dhe ne piken 3 te nenit 1 thuhet: kërkohet nga zyrtaret e prokurimit që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe

burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Si dhe ne piken 2 thuhet: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. AK ne mënyrë te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit dhe ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se dhe ne kundërshtim me nenin 43 te Rregullores për prokurim publik 01/2022 te KRPP-se ku shume qarte ne nenin 43.5 dhe 43.7 te kësaj rregulloreje janë te specifikuara kushtet se kur mundet te anulohet një procedure e prokurimit pas hapjes se ofertave. Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe oferta jone është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Agri Bau Sh.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, të LPP-së, si dhe AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Rregulloreve te KRPP-se. Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues i OSHP-se qe pretendimin tone ta konstatoj te bazuar gjithashtu kërkojmë edhe nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së qe te nxjerr: Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik Agri Bau Sh.P.K. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Piruner" për pjesën 1 dhe pjesën 2 me nr. te prokurimit: 214-23-8209-1-2-1 te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës. Anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Policia e Kosovës për anulim te aktivitetit te prokurimit: "Furnizim me Piruner" për pjesën 1 dhe pjesën 2 me nr. te prokurimit: 214-23-8209-1-2-1 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim për pjesën 1 dhe pjesën 2 dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim-

AK nuk ka bërë shkelje të neneve të lartë perënduara pasi gjatë vlerësimit të ofertave janë respektuar të gjitha dispozitat e LPP-se, në vijim japim sqarime të detajuara: Pretendimet se AK ka shkelur nenin 1 te LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se në mënyre me te drejt dhe efikase ka shfrytëzuar fondet publike, duke publikuar njoftimin për kontrate me procedure te hapur duke mos diskriminuar ose favorizuar asnjë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet Ne dosjen e tenderi dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar sigurimi i tenderit i cili eshte bashkangjitur ne vendim te AK-së. për këtë aktivitet te prokurimit oferta e Juaj është e pa përgjegjshme pasi që Autoriteti Kontraktues përmes E-prokurimi ka ngarkuar Kërkesën për Zgjatjen e Validitetit të Ofertës 25.10.2023, nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit të bëjnë zgjatjen e validitetin e ofertës për 60 dite nga data skadimit te validitetit te ofertës tuaj si dhe sigurimit te tenderit për një periudhe prej 90 ditës nga data e skadimit te sigurimit te tenderit. OE ankues " Agri Bau" Sh.P.K. me datën 25.10.2023 ka ngarkuar në E-prokurim. Duke ju referuar dokumentit qe është ngarkuar ne Eprokurim Operatori Ekonomik ankues ka bere vazhdimin e validiteti te ofertës mirëpo për vazhdimin e signrimit te ofertës vetëm ka specifikuar se vazhdohet për një periudhe prej 90 ditësh nga data e skadimit te sigurimit te tenderit mirëpo duke mos bashkangjitur si dëshmi se është bere vazhdimi i

sigurimit te ofertës. Afati i fundit për përgjigje dhe ngarkimin e dokumenteve ka qene me së largu deri me 30/10/2023 ora 16:00. Nga kjo vërehet se OE ankues nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se ka bërë vazhdimin e sigurimit te ofertës nga kompania e sigurimeve. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar dhe pa dëshmi për vazhdimin e sigurimit të ofertës. Oferta e OE ankues është pa mbulushmeri te sigurimit te tenderi 41 dite kalendarike. Ne lidhje me pretendimin se AK ka shkelur nenin 6 te LPP, nuk qëndron pasi AK, të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ne këtë aktivitet te prokurimi Autoriteti kontraktues duke marre ne konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit fondet publike i ka përdorë ne mënyrën ekonomike pasi qe oferta e Juaj është e papërgjegjshme pasi që si OE nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi se keni bërë vazhdimin e sigurimit te ofertës nga kompania e sigurimeve. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ku të gjithë Operatoret Ekonomik pjesëmarrës ne ketë aktiviteti i ka trajtuar të barabartë. Po ashtu AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit obligohet qe tenderi i zgjedhur te përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse sipas njoftimit për kontratë dhe FDT-se andaj ofertën e juaj AK e ka trajtuar njësoj si gjithë OE tjerë duke mos bere dallime, mirëpo oferta e juaj është e papërgjegjshme pasi qe si OE nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi se keni bërë vazhdimin e sigurimit te ofertës nga kompania e sigurimeve. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimi se AK ka bërë shkeljen Neni 56 te LPP-ës, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, AK- Polica e Kosovës gjatë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ka bërë vlerësimin në harmoni me kërkesat e kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit mirëpo oferta e juaj është e papërgjegjshme pasi qe si OE nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi se keni bërë vazhdimin e sigurimit te ofertës nga kompania e sigurimeve. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 59 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bere shkelje pasi që vlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimin për kontrate dhe specifikacionet teknike te detyrueshme te Aneksi 1 i dosjes se tenderit, pasi qe ju si ofertues nuk i keni bere vazhdimin e sigurimit te ofertës brenda afateve te përcaktuar ne kërkesën e Autoriteti Kontraktues te datës 25/10/2023. Andaj, oferta e Juaj është e papërgjegjshme pasi që si OE nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi se keni bërë vazhdimin e sigurimit te ofertës nga kompania e sigurimeve brenda afateve të caktuara ne kërkesën për zgjatje te sigurimit te ofertës. Ju keni bere vazhdimin e sigurimit te ofertës pas kërkesës se AK si dhe pas Vendimit te njoftimit për anulim i publikuar me datën 11.01.2024 ne E prokurim. Vazhdimi sigurimit te ofertës e keni bërë me date 12/01/2024. Sigurimi i tenderit i dorëzuar se bashku me ofertën e dorëzuar të datës 01/09/2023 ka pas validitet deri me date 01/12/2023. Ndërsa vazhdimin e sigurimit te ofertës e keni bere me date 12/01/2024 qe do të thotë se oferta e juaj nuk ka pasur validitet te sigurimit prej datës 02/12/2023 deri me datën 11/01/2024 qe i bie plotë 41 dite kalendarike si ne vijim dhe kjo është ne kundërshtim me LPP nenin 57 paragrafi 2. Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit AK ka kërkuar zgjatjen e validiteti sipas LPP-se dhe Rregulloren 001/2022 si sipas njoftimit për kontrate dhe FDT-se (validiteti i ofertës 60 dite si dhe Validiteti i sigurimit te tenderit 90 dite). OE ankues sipas deklaratës qe ka ofruar për vazhdim te sigurimit nga data e skadimit nuk ka ofruar vazhdimin e sigurimit te tenderit ne sistem te E- prokurimti deri me datën 12.01.2024 ky sigurim i ofruar është 41 dite kalendarike me vonës dhe është ne kundërshtim me Rregulloren 001/2022 nenin Neni 28 Sigurimi i

Tenderit paragrafi 28.6 Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Andaj, nga kjo fakte te paraqitura Pretendimi i OE ankues është plotësisht i pa bazuar. Pretendimet se AK ka shkelur Nenin 60 te LPP-ës Kriteret për Dhënien e Kontratës është zbatuar ne përpikeni të plot pasi që për këtë aktivitet te prokurimit asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm pasi qe asnjeri nga ofertuesit nuk ka bere vazhdimin e sigurimit te ofertës duke ju përfshirë edhe Juve si Operator ekonomik ankues si oferte e pa përgjegjshme. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Në lidhje me pretendimin se AK ka shkelur nenin 62 te LPP-ës, nuk qëndron fakti pasi AK në përputhje të plotë me nenin 62 ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi pasur asnjë ofertë të përgjegjshme. Sa i për këtë pretendimeve se "Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Rregulloreve te KRPP-se" AK sqaron se ne kërkesën për rishqyrtim nuk keni specifikuar se cilat nene janë shkelur te kësaj Rregullores. Ne lidhje me këtë ju sqarojmë se pretendimet e juaja janë ete pa bazuara pasi qe oferta e juaj është e pa përgjegjshme pasi që si OE nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi se keni bërë vazhdimin e sigurimit te ofertës nga kompania e sigurimeve. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar."

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 82/2024, ndërsa me datë 13.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/82 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është Pajtur lidhur me mendimin e ekspertit.

-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE "Agri Bau Sh.P.K." - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/82 ka vlerësuar si në vijim-

Sqarim fillestar lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Piruner",me numër të prokurimit: 214-23-8209-1-2-1, të iniciuar nga AK – Policia e Kosovës.Konstatimi i parë (I): "Operatori Ekonomik ankues sipas ankesës si pretendim te vetëm ankimor ka ngritur arsyetimin e anulimit te aktivitetit te prokurimit, përkatësisht arsyetimin e eliminimit te potencuar ne letrën standarde te datës 11.01.2024, ku është potencuar se OE ankues "AGRI BAU" sh.p.k. Prishtine, është eliminuar pasi qe me datën 25.10.2023, AK - Policia e Kosovës ka kërkuar nga i njëjti OE qe te zgjas validetetin e ofertës për një përudhë prej 60 ditësh nga data e skadimit te ofertës dhe Sigurimit te Tenderit për një përudhë prej 90 ditësh nga data e skadimit te sigurimit te tenderit. AK ka kërkuar nga OE qe dërgimin i dokumentit për AK te behet me se largu deri me datën 30.10.2023 ne ora 16:00h. Eksperti shqyrtues pretendimin ankimor te OE ankues e kualifikon ne tersi si te bazuar, pasi qe OE ankues i është përgjigjur kërkesës se AK, bazuar ne kërkesën e tyre përkatësisht OE ankues sipas Polises se Sigurimit te tenderit te dorëzuar ne ofertë e ka pasur valide deri me datën 01.12.2023, ku i njëjti e ka vazhduar nga data 12.01.2024 deri ma datën 12.04.2024, rrjedhimisht OE ankues ne vazhdimësi ka pasur mbulese Sigurimin e Tenderit. Këtë e mbështesim ne dispozita ligjore konkretisht te nenin 57 te LPP-se, përkatësisht AK Policia e Kosovës përmes kërkesës se datës 25.10.2023, ka kërkuar nga ofertuesit qe vazhdimi i vlefshmërisë se tenderit dhe sigurimit te ekzekutimit te behet pas datës se skadimit te tyre. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se

anulimi i aktivitetit te prokurimit me arsyetim te tillë bie ndesh me nenin 62 te LPP-se, kështu qe propozimi ynë është qe lënda te kthehet ne rivlerësim konform nenit 59 te LPP-së. Prova e Polisat e Sigurimit te Tenderit është e bashkangjitur ne ekspertizë."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Agri Bau Sh.P.K." Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Agri Bau Sh.P.K."

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje pretendimin ankimor, të njëjtat të cilat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhëne shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Rrjedhimisht, paneli nuk e mbështet arsyeshmërinë e ekspertizës që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, ngase vet eksperti shqyrtues evidenton se e OE ankues nuk e ka bere vazhdimin e sigurimit ofertës në afate kohore sipas kërkesëse së AK, duke i paraqitur dokumnetet e sigurmit, me data, në ekspertize, dhe pa asnjë arsyetim faktik e ligjor, nxjerr rekomandim të gabuar në kundërshtim e LPP-se, që lënda të kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues vrenë se operatori ekonomik ankues, sigurimin e tenderit se bashku me ofertën e dorëzuar e ka pasur prej datës, 01/09/2023, e deri me date 01/12/2023, me afat 3 mujor.

Autoriteti kontraktues me datën, 25.10.2023, i është drejtuar me Kërkesë me shkrim OE ankues per vazhdimin e sigurimit të tenderit, me afat deri me 30.10.2023, nga data e skadimit te sigurimit te tenderit. OE ankues sigurimin e tenderit e ka bë me datën 12.01.2024 te Kompania e Sigurimit "PRISING" me afat prej 12.01.2024 deri me 12.04.2024.

Nga krahasimi i dokumeteve të sigurimit të tenderit vrehet se oferta e OE ankues, nuk ka pasur validitet të sigurimit tenderit prej datës, 02/12/2023 deri me datën,11/01/2024, andaj Paneli shqyrtues konstaton, se për 41 dite kalendarike oferta tenderuse nuk ka pasur validitet te sigurimit të tenderit dhe me shkeptuje kohore të validitetit të ofertes dhe kjo është në kundërshtim me LPP nenin 57 paragrafi 2. përcakton" *Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit".*

Paneli shqyrtues vëren se Autoriteti Kontraktues ka nxjerr vendim duke u bazuar në dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me anulimin e aktivitetit prokurimit, neni 43.5 i Rregullores për Prokurim Publik përcakton" *Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm".*

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e AK dhe arsyet e anulimit të paraqitura edhe përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim u bind se ky aktivitet të prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim. Andaj, paneli shqyrtues nuk mund të detyroj AK që të vazhdoj me një aktivitet të prokurimit i cili ka shkelje dhe mund të paraqet vështirësi gjatë realizimit të kontratës.

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me

shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: